

FTESË PËR TRAJNIME DHE GRANTE NË BUJQËSI

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin *“Fuqizimi i të rinjve dhe grave nga zonat rurale përmes përfshirjes në bujqësi dhe përpunim të ushqimit”* projekt tre-vjeçar (2021-2023), i përkrahur donatori Zvicran CFD. Projekti do të përfshijë komunat: **Vushtrri, Mitrovicë, Shitme dhe Lipjan**, të cilat janë partnere të projektit.

Projekti ka për qëllim tri komponentet kryesore të përkrahjes, si: *Ngritje e kapaciteteve përmes Arsimit dhe Aftësimin Profesional, Mbështetje me grante për krijimin e kushteve për gjenerimin e të ardhurave dhe vetëpunësimin dhe Promovimi i përfshirjes së të rinjve, grave dhe burrave nga zonat rurale në bujqësi.*

Mbështetja e të rinjve me trajnime dhe grante: Në kuadër të aktiviteteve të projektit është planifikuar formimi i dy grupeve me nga 15 pjesëmarrës nga dy komunat e përfshira në projekt, për të cilët fillimisht do të organizohen trajnime pesë (5)-ditore për ngritje të kapaciteteve në temat për përgatitjen e planit të biznesit, menaxhimin e fermave dhe teknikave të prodhimit. Pas përfundimit të trajnimeve, këta të rinjë do të ftohen të aplikojnë në skemën e granteve me pako mbështetëse në nënsektorët e bujqësisë (blegtori, bletari, perimtari, pemëtari, etj.) në vlerë nga 2,500.00 €.

Mbështetja e grave me trajnime profesionale dhe grante në sektorin e përpunimit: Në kuadër të aktiviteteve të projektit është planifikuar formimi i dy grupeve me nga 12 pjesëmarrëse nga dy komunat e përfshira në projekt, për të cilat do të organizohen 20 ditë trajnime profesionale në sektorin e përpunimit (frutave dhe perimeve apo qumështit) të akredituara nga Autoriteti Kombtar i Kualifikimeve (AKK). Pas përfundimit të trajnimeve gratë do të pajisen me certifikata të lëshuara nga IADK dhe të verifikuara nga AKK. Pas certifikimit dy kandidatet më të suksesshme nga dy komunat do të mbështetën me pajisje për përpunim në vlerë 7,000.00€.

Andaj, **ftohen** të rinjtë dhe gratë që të aplikojnë për vijimin e trajnimeve bujqësore dhe në sektorin e përpunimit, të cilët pas përfundimit të trajnimeve, do të aplikojnë për skemën e granteve të lartëcekura.

Kriteret që duhet plotësuar TË RINJTË për trajnime janë:

- Të jenë me moshë 18-35 vjeç;*
- Të jenë nga zonat rurale të komunave Vushtrri dhe Lipjan;*
- Të jenë të papunë dhe aktivë në veprimtarit bujqësore;*
- Të kenë resurse për t’u angazhuar në bujqësi (tokë, uji, fuqi punëtore);*
- Të kenë potencial për zgjerim të kapaciteteve bujqësore;*
- Të jenë të interesuar për të filluar një biznes apo për t’u vetëpunësuar.*

Kriteret që duhet plotësuar GRATË për trajnime janë:

- Të jenë me moshë 18-55 vjeç;*
- Të jenë nga zonat rurale të komunave Vushtrri dhe Lipjan;*
- Të jenë të papuna dhe aktive në përpunim të ushqimit;*
- Të kenë potencial për zgjerim të kapaciteteve të përpunimit;*
- Të jenë të interesuara për të filluar një biznes apo për t’u vetëpunësuar;*
- Gratë kryefamiljare do të kenë përparësi të përzgjedhjes.*

Aplikacioni mund të merren në zyrat e IADK-së dhe zyrat për bujqësi në komunat **Vushtrri dhe Lipjan**, ose mund t’i kërkoni në e-mailin: behare.mlinaku@gmail.com apo behare.mlinaku@iadk.org. Aplikacioni duhet të dorëzohet në zyrat e IADK-së apo zyrat për bujqësi në komunat përkatëse dhe gjithëashtu në e-mail të lartëcekur.

Aplikacionet duhet të dorëzohen deri me datë 26.03.2021 në ora 16:00.

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri

Është jelojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadk.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadk.org

